



**PUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ZHVENDOSJA E PORTËS 4 (PROJEKTIM, ZBATIM)”
(Procedurë e Hapur- Pune)– kontrate me çelësa ne dorë

VLERA E FONDIT LIMIT: 26,792,580 (njëzet e gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë) Leke pa TVSH

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Sherbime per projektim te arkitektures 71220000-6
 - Sherbim per projektim ndertesash 71221000-3
 - Pregatitje per projektim dhe dizajn,vleresim i kosos 71242000-6
 - Punime ndërtimi 45210000-2
 - Instalime hidraulike 43328000-8
 - Instalime elektrike dhe montim 45311000-0
 - Instalime të pajisjeve sinjalizuese 45316200-7
 - Instalime të pajisjeve të ndriçimit rrugor 45316110-9
 - Instalime të pajisjeve të sinjalizimit të portit 45316230-6
 - Sisteme kohë-shënuese regjistruar të orarit të punës 35125200-8
 - Barriera sigurie 34928310-4,
- Afati për përfundimin dhe dorëzimin e projektit të zbatimit është **30 ditë kalendarike** nga data e lidhjes së kontratës.
 - Afati për realizimin e punimeve të zbatimit është **60 ditë kalendarike** nga data e njoftimit për fillimin e punimeve.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre vitet e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të viteve financiare** duhet të jetë jo më e vogël se vlera së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se fondi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të

deklaruar në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenet 40, pika 4 dhe neni 47, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Liçensat profesionale ne projektim

Subjektet pjesëmarrëse kërkohen të zotërojnë, Liçenca ne Projektim, referuar Vendimit nr. 943, Date 28. 12. 2016, për “Liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”:

- Projektues arkitekt – Kat. 2, pika a, projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike
- Projektues konstruktor – Kat 3, pika a, objekte civile – industrial
- Projektues instalator – Kat 4, pika c, projektim të linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industrial
- Projektues vepra hidraulike – Kat 5, pika c, projektim ujesjelles kanalizime urbane-rurale
- Projektues Rruge – Kat 6, pika a, rruge urbane dytesore
- Projektues gjeodet –Kat 8, pika a, rlevime inxhinjerie
- Projektues të sinjalizimit rrugor – Kat 11, pika a, Projektim sinjalistike jondircuese ne rruge lokale, rruge urbane dytesore.

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë liçenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategorite në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së liçencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim.

Duhet të dorëzohet liçenca në projektim e shoqërisë si dhe liçenca individuale e drejtuesit teknik me pikat përkatëse. Në rastin kur subjekti që ushtron veprimtari në fushën e projektimit është person fizik të paraqitet vetëm liçenca profesionale personale në projektim për pikat e kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a dhe pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 943, Datë 28. 12. 2016, për “Liçencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

2.3.3 Mbi certifikimet e kompanisë së projektimit

- Certifikate për Sistemin e menaxhimit të cilësive (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).

Shënim: Certifikatat e mësipërme/ekuivalentet duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombetare dhe në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zerave të punimeve që do të marre për të realizuar sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurimet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është një standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.4 Liçencat profesionale në zbatim të punimeve të ndërtimit

Subjektet zbatuese, pjesëmarrëse në konkurim duhet të zotërojnë, Liçenca profesionale të Zbatimit, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”:

- N.P – 1, A Punime gjurmimi në tokë,
- N.P – 2, A Ndërtime civile dhe industriale
- N.P – 4, A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, për punimet rrugore, shtresat asfaltike, korsitë, sheshet dhe infrastrukturën rrugore të portës.
- N.P – 7, A Ujësjellës, kanalizime,
- N.S – 1, A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 6, A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese, për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.
- N.S – 13, A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- N.S – 14, A Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj., për instalimet elektrike, rrjetet IT, kontroll-aksesin, komunikimin dhe pajisjet ndihmëse.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, liçencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet liçenca profesionale.

Liçencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga liçenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumatorja e pikave të liçencave individuale të stafit inxhinierik i cili në rastin e shpalljes fitues së shoqërisë do të jetë stafi inxhinierik i realizimit të punimeve.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të Republikës së Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

Argumentimi i liçencave profesionale të zbatimit të punimeve

Kërkesat për liçencat profesionale të zbatimit janë vendosur në nivelin ****A****, si niveli minimal i kërkuar për kategoritë përkatëse, me qëllim garantimin e kapacitetit teknik të operatorit ekonomik, pa krijuar kufizim të panevojshëm të konkurrencës. Këto kategori lidhen drejtpërdrejt me zërat e punimeve të parashikuara në Termat e Referencës, në preventivin paraprak orientues dhe në anekset teknike të procedurës.

N.P – 1, A – Punime gjurmimi në tokë

Kategoria N.P – 1, A – Punime gjurmimi në tokë, është e nevojshme pasi objekti përfshin ndërhyrje në terren për përgatitjen e gjurmës së re të Portës nr. 4, përgatitjen e bazamentit të shtresave rrugore, hapjen e kanaleve dhe gjurmimeve për tubacione, pusetat, rrjetet elektrike/IT, bazamentet e pajisjeve dhe elementet ndihmëse. Në preventivin paraprak orientues janë parashikuar zëra që lidhen drejtpërdrejt me gjurmimin dhe përgatitjen e terrenit, si “Gjurmim dheu + transport”, prishje shtresash ekzistuese, skarifikim, përgatitje shtresash dhe punime për rrjete nëntokësore. Këto punime kërkojnë kapacitet profesional për ekzekutimin e punimeve të gjurmimit, administrimin e materialeve të dala nga gjurmimi, mbrojtjen e rrjeteve ekzistuese dhe garantimin e qëndrueshmërisë së bazamentit.

N.P – 4, A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

Kategoria N.P – 4, A është e nevojshme pasi objekti ka karakter të theksuar rrugor/infrastrukturor dhe përfshin rikonceptimin e hyrje-daljes së Portës nr. 4, krijimin e korsive hyrëse dhe dalëse, sistemimin e shesheve, ndërtimin/riparimin e shtresave rrugore, asfaltimin, vendosjen e bordurave, trotuareve, ishujve ndarës dhe elementeve të tjera të infrastrukturës së qarkullimit. Në Termat e Referencës është parashikuar realizimi i shtresave rrugore, përfshirë shtresa çakëlli, stabilizanti, konglomerati, binderi dhe asfaltobetoni, si dhe disiplinimi i flukseve të mjeteve në hyrje-dalje të portës. Në preventivin orientues janë parashikuar zëra si shtresa stabilizanti, konglomerati, binderi, asfaltobetoni, prerje asfalti, skarifikim, bordura dhe sipërfaqe rrugore.

N.P – 7, A – Ujësjellës, kanalizime

Kategoria N.P – 7, A – Ujësjellës, kanalizime, është e nevojshme pasi objekti përfshin ndërtimin, përshtatjen dhe lidhjen e rrjetit të ujërave të shiut/kullimit në zonën e portës. Kjo lidhet me domosdoshmërinë për të garantuar largimin e ujërave atmosferike nga korsitë, sheshet, trotualet dhe zonat ku do të vendosen pajisjet e kontroll-aksesit dhe instalimet elektrike/IT. Në preventivin paraprak orientues janë parashikuar puseta betoni, puseta shiu, kapakë gize, puseta plastike/teknike dhe

tubacione, të cilat lidhen me rrjetet e kullimit dhe me kalimet nëntokësore. Realizimi i gabuar i këtyre elementeve mund të shkaktojë grumbullim ujërash, dëmtim të shtresave rrugore, dëmtim të instalimeve elektrike/IT dhe cenim të funksionimit të portës.

N.S – 1, A – Punime për prishjen e ndërtimeve

Kategoria N.S – 1, A – Punime për prishjen e ndërtimeve është e nevojshme pasi objekti përfshin prishje të shtresave ekzistuese, prerje asfalti, skarifikim, si dhe prishje të elementeve ekzistuese prej betoni apo betonarmeje që pengojnë realizimin e gjurmës së re të portës, ndërtimin e shtresave rrugore, vendosjen e pusetave, tubacioneve, bazamenteve dhe pajisjeve. Në preventivin orientues janë parashikuar zëra të posaçëm për prishje shtresash ekzistuese, prishje muresh beton/arme, prishje kollonash/trarësh b/a dhe ndërhyrje në elemente ekzistuese. Këto punime kërkojnë kapacitet profesional për kryerjen e prishjeve në mënyrë të kontrolluar, pa cenuar rrjetet ekzistuese, sigurinë e kantierit, qarkullimin portual dhe asetet e Autoritetit Kontraktues.

N.S – 6, A – Sinjalistika rrugore jo ndriçuese

N.S – 6, A – Sinjalistika rrugore jo ndriçuese, është e nevojshme pasi objekti përfshin riorganizimin e qarkullimit në hyrje-dalje të Portës nr. 4 dhe kërkon realizimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale për disiplinimin e flukseve të mjeteve dhe këmbësorëve. Në Termat e Referencës është parashikuar realizimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale, përfshirë vijëzimet gjatësore, anësore, kalimet e këmbësorëve, shenjat orientuese dhe paralajmëruese. Në preventivin paraprak orientues janë parashikuar zëra për vijëzime gjatësore/anësore dhe vijëzime të kalimit të këmbësorëve. Duke qenë se porta është pikë kontrolli dhe hyrje-daljeje në territor portual, sinjalistika është element i domosdoshëm për sigurinë, orientimin, shmangien e konflikteve të trafikut dhe funksionimin normal të portës.

N.S – 13, A – Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

N.S – 13, A – Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, është e nevojshme pasi objekti përfshin ndërtimin dhe/ose përshtatjen e infrastrukturës së komunikimit për funksionimin e Portës nr. 4, përfshirë kabllimin data, fibrën optike, patch panelet, rack-un, switch-et, SFP-të, lidhjet e komunikimit dhe integrimin me rrjetet ekzistuese të Autoritetit Portual Durrës. Në Aneksin 2 dhe në preventivin paraprak orientues janë parashikuar zëra për kablllo FTP, patch fiber, patch panel fiber, patch panel RJ45, SFP, switch-e industriale, rack, UPS dhe elemente të tjera të komunikimit. Këto punime nuk janë vetëm furnizime pajisjesh, por përfshijnë instalim, lidhje, organizim dhe testim të infrastrukturës së komunikimit.

N.S – 14, A – Impiante të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.

Kategoria N.S – 14, A, është e nevojshme pasi objekti përfshin instalime elektrike dhe elektroteknike, furnizim me energji, panele shpërndarëse, kablllo elektrike, ndriçim, tokëzim, lidhje të pajisjeve IT/kontroll-akses, lidhje të barrierave, loop-detektorëve, fotocelulave, llambave sinjalizuese, butonave të komandimit dhe pajisjeve të tjera ndihmëse. Në Termat e Referencës janë parashikuar punime elektrike, ndriçim, sistem tokëzimi, lidhje të pajisjeve të kontrollit dhe instalime në ambientin teknik. Në preventivin orientues janë përfshirë kablllo elektrike, tuba mbrojtës, panel shpërndarës elektrik, ndriçues, sistem tokëzimi, automatë, ushqyes, llamba sinjalizimi, kuti elektrike dhe elemente të tjera të instalimit elektrik. Kjo kategori është e domosdoshme për sigurinë elektrike, funksionimin e pajisjeve, mbrojtjen e përdoruesve, furnizimin e kontroll-aksesit dhe dorëzimin e objektit në gjendje funksionale.

2.3.5 Mbi certifikimet e kompanisë per shogerine e zbatimit

- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te cilesise (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).

- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- Çertifikate per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).

Shënim: Çertifikatat e mësiperme/ekuivalentet duhet të jenë të lëshuara nga Institucione të çertifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombetare dhe në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zerave të punimeve që do të marre persiper të realizojë sipas akt marreveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe sigurinë e informacionit janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto çertifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.6 Stafi i projektimit

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, për pikat e licencave që kërkojnë në projektim për shoqërinë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, liçence profesionale personale, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për liçencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.7 Stafi ne zbatim

Operatori ekonomik ose anëtari i BOE-së që merr përsipër zbatimin e punimeve duhet të disponojë stafin drejtues teknik të nevojshëm për kategoritë e punimeve që merr përsipër, në përputhje me licencën profesionale të zbatimit dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Drejtues teknik në licencën e shoqërisë, për pikat e licencave që kërkojnë në zbatim për shoqëri, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast

rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik për realizimin e projektit duhet të disponojë:

Operatori ekonomik/BOE duhet të disponojë staf teknik të kualifikuar për instalimin, konfigurimin dhe testimin e pajisjeve të kontroll-aksesit, barrierave automatike dhe rrjetit IT. Për këtë qëllim kërkohet:

1. Të paktën 1 specialist me formim në fushat Elektronikë, Informatikë, Kompjuterikë, Telekomunikacion, Automatizim, Elektrik ose profil tjetër ekuivalent, i certifikuar/trajnuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për instalimin/konfigurimin e barrierave automatike ose pajisjeve ekuivalente të kontroll-aksesit

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë për specialistin e deklaruar: diplomë përkatëse, certifikatë për pajisjet barriera si dhe listëpagesat e shoqërisë ku specialisti të figurojë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është e nevojshme pasi barrierat përbëjnë element kritik të kontrollit fizik të hyrje-daljeve në portë dhe duhet të instalohen, konfigurohen dhe testohen në mënyrë të saktë. Pajisjet e barrierave nuk janë pajisje të thjeshta mekanike, por përfshijnë motorë, njësi kontrolli, sensorë, fotocelula, loop detector, module komandimi, lidhje me sisteme kontroll-aksesi dhe elementë sigurie. Prania e një inxhinieri të certifikuar për pajisjen Barriera garanton që instalimi dhe konfigurimi të realizohen sipas kërkesave teknike të prodhuesit, duke shmangur defektet në funksionim, keqkalibrimin e pajisjeve, rrezikun për përdoruesit dhe ndërprerjen e operimit normal të portës. Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit dhe me nevojën për dorëzim të pajisjeve në gjendje të plotë funksionale.

2. Të paktën 1 Inxhinier Elektrik

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë për specialistin e deklaruar:, diplomë përkatëse, si dhe listëpagesat e shoqërisë ku specialisti të figurojë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është e nevojshme për shkak të natyrës së objektit, i cili përfshin punime elektrike, instalimin e paneleve, ndriçimit, tokëzimit, kabllimeve dhe lidhjeve elektrike për pajisjet e kontroll-aksesit dhe sistemet IT.

Angazhimi i këtij profili siguron mbikëqyrjen teknike, realizimin korrekt të instalimeve, testimin dhe vënien në funksionim të sistemeve elektrike, në përputhje me projektin dhe kërkesat teknike të objektit. Për këtë arsye, kriteri konsiderohet i domosdoshëm dhe proporcional me natyrën dhe volumnin e punimeve.

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për pajisjet kryesore objekt prokurimi, konkretisht për:

- Barriera automatike;
- Switch industrial i menaxhueshëm.

Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve.

Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqiten certifikatat/dëshmit ose deklarata konformiteti sipas Standarteve dhe kërkesave në specifikimet teknike.

Argumentimi:

Kjo kërkesë vendoset me qëllim garantimin e origjinës së pajisjeve, sigurimin që produktet e ofruara janë origjinale dhe të mbështetura nga zinxhiri zyrtar i furnizimit, si dhe garantimin e mbështetjes teknike, garancisë dhe shërbimit pas shitjes.

Duke qenë se barrierat automatike dhe switch-i industrial janë pajisje kryesore për funksionimin e sistemit të Portës nr. 4, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kontrollin e hyrje-daljeve, komunikimin e rrjetit, sigurinë dhe vazhdimësinë operacionale, është e nevojshme që

Autoriteti Kontraktor të ketë siguri se këto pajisje furnizohen nga burime të autorizuara dhe të verifikueshme.

Paraqitja e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar shërben gjithashtu për të shmangur furnizimin me pajisje të paautorizuara, të papajtueshme, jashtë zinxhirit zyrtar të furnizimit ose pa mbështetje teknike të garantuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pajisje që kërkojnë instalim, konfigurim, integrim, mirëmbajtje dhe furnizim me pjesë këmbimi gjatë periudhës së përdorimit.

2.3.10 Numri i punonjesve

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues ose Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë duhet të ketë numrin e nevojshëm të stafit për realizimin e kontratës “projektim + zbatim”. Numri minimal i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më i vogël se 20 punonjës për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Në këtë numër minimal përfshihet stafi i nevojshëm për projektimin, drejtimin teknik, zbatimin e punimeve, instalimet elektrike, IT/kontroll-aksesin, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe punonjësit ndihmës të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, ky kriter përmbushet nga BOE në total, në përputhje me pjesët e kontratës që secili anëtar merr përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Drejtnesit/manovratorët e mjeteve që disponohen me qira apo nëpërmjet kontratave të shërbimit nuk është e domosdoshme të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues, me kusht që disponimi i tyre të provohet nëpërmjet kontratës përkatëse të qirasë/shërbimit apo dokumentacionit tjetër provues.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Vërtetim nga Administrata Tatimore, si edhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/SIG-25, për të gjithë periudhën e kërkuar.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë disponibilitetin e numrit të kërkuar të punonjësve për gjatë gjithë periudhës së realizimit të shërbimit, konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kriteret mbi fuqinë punëtore, të nevojshme përmbushen me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me

kohështrirje gjashte muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

Objekti “Zhvendosja e Portës 4 (Projektim, Zbatim)” nuk është një kontratë e thjeshtë zbatimi punimesh, por një procedurë e integruar “projektim + zbatim / me çelësa në dorë”, e cila kërkon angazhimin e kapaciteteve njerëzore për të dyja fazat: fazën e projektimit dhe fazën e zbatimit. Për rrjedhojë, numri minimal i punonjësve nuk duhet të vlerësohet vetëm mbi bazën e punëtorëve të thjeshtë apo punonjësve të kantierit, por mbi bazën e gjithë stafit të nevojshëm për realizimin e kontratës, duke përfshirë projektuesit, drejtuesit teknikë, specialistët, punonjësit e zbatimit, stafin elektrik/IT, përgjegjësin e sigurisë dhe personelin ndihmës.

Në këtë procedurë kërkohet hartimi i projektit të zbatimit, përfundimtar, grafikut të detajuar, dokumentacionit teknik, aplikimeve përkatëse, si dhe realizimi i punimeve civile, rrugore, elektrike, IT/kontroll-akses, kullimit, sinjalistikës, vendosjes së zyrës konteinerike, instalimit të pajisjeve dhe testimit/dorëzimit përfundimtar të objektit. Këto detyra kërkojnë një organizim minimal njerëzor të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm.

Në përlogaritjen e kapacitetit minimal njerëzor janë marrë në konsideratë këto grupe kryesore:

1. Stafi i projektimit, i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit, ku përfshihen projektues për disiplinat arkitekturore/funksionale, konstruktive, rrugore, elektrike, telekomunikacion, kontroll-akses, ndriçim, kullim, gjeodezi dhe sinjalistikë;
2. Stafi drejtues teknik për zbatimin, i nevojshëm për drejtimin dhe koordinimin e punimeve në terren, sipas kategorive të punimeve që do të realizohen;
3. Specialistët elektrikë dhe elektronik, janë të nevojshëm për instalimin, lidhjen, konfigurimin dhe testimin e rrjetit elektrik, rrjetit IT, barrierave automatike, switch-eve, loop-detektorëve, fotocelulave dhe pajisjeve të komunikimit;
4. Punonjësit e zbatimit, të nevojshëm për kryerjen e punimeve civile, rrugore, shtresave, asfaltimit, bordurave, pushtave, tubacioneve, sinjalistikës dhe punimeve ndihmëse;
5. Personeli për sigurinë dhe shëndetin në punë, i nevojshëm për administrimin e sigurisë në kantier, duke qenë se punimet zhvillohen në zonë portuale operative, me qarkullim mjeteve dhe kërkesa të veçanta sigurie;
6. Personeli ndihmës dhe koordinues, i nevojshëm për organizimin e kantierit, furnizimet, administrimin teknik, koordinimin me Autoritetin Kontraktues dhe strukturat përkatëse të APD-së.

Nga analiza e mësipërme rezulton se kapaciteti njerëzor i nevojshëm për realizimin e kontratës, duke përfshirë si fazën e projektimit ashtu edhe fazën e zbatimit, e tejkalon teorikisht numrin prej 20 personash. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe moskufizimit të konkurrencës, nuk ka kërkuar numër më të lartë punonjësish, por ka përcaktuar si nivel minimal vetëm 20 punonjës, i cili konsiderohet kufiri minimal i arsyeshëm për garantimin e kapacitetit organizativ dhe teknik të operatorit ekonomik/BOE-së.

Kjo kërkesë është e lidhur me nenin 77, pika 1 dhe pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me nenin 39, pika 4, të VKM-së nr. 285/2021, të ndryshuar, pasi i shërben

vërtetimit të aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën me sukses, brenda afateve, me cilësi dhe pa cenuar funksionimin e portit.

Kërkesa për 20 punonjës nuk nënkupton domosdoshmërisht që drejtuesit/manovratorët e mjeteve të marra me qira duhet të jenë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Në rastin kur mjetet apo makineritë disponohen me qira ose përmes kontratës së shërbimit, drejtuesit/manovratorët e tyre mund të disponohen përmes dokumentacionit përkatës të qirasë/shërbimit, pa qenë e nevojshme të përfshihen në numrin minimal prej 20 punonjësish të siguruar.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kriteri për numrin minimal prej 20 punonjësish përmbushet nga BOE në total, në përputhje me pjesët e projektimit, zbatimit, furnizimit, instalimit apo shërbimeve që secili anëtar merr përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit. Kjo garanton që kriteri të mos jetë diskriminues dhe të mos kërkojë që një operator i vetëm të disponojë të gjithë stafin, por që kapaciteti njerëzor i nevojshëm të mbulohet nga bashkimi në tërësi.

2.3.11 Specialistet

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë ofertuese, për të gjithë periudhën e kërkuar, të paktën:

- 1 (nje) Teknik Ndërtimi,
- 4 (katër) Elektriciste
- 1 (nje) punëtor asfalti
- 4 (katër) Punëtor të Thjeshtë
- 1 (nje) Karpentier
- 1 (nje) Automakinist
- 1 (nje) Eskavatorist
- 1 (nje) Shofer

Për punonjësit manovrator dokumentimi mund të bëhet në një nga format e mëposhtme:

- përmes listëpagesave të operatorit ekonomik, kur mjeti është në pronësi ose përdoret nga vetë operatori;
- përmes kontratës së qirasë/shërbimit, kur mjeti merret me qira bashkë me drejtuesin/manovratorin;
- përmes kontratës së angazhimit/shërbimit me person/subjekt të kualifikuar, për periudhën e zbatimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik, kontratat e punës të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (deshmi kualifikimi profesional / certifikate / diplome) leshuar nga institucione të licensuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore sipas ligjit nr.15/2017 Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

***Argumentimi:** Kjo kerkese eshte vendosur bazuar ne nenin 77/4 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin publik, e cila ka lidhje teknike me objektin qe prokurohet dhe eshte proporcionale me objektin e kontrates. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*

2.3.12 Siguria dhe shëndeti ne pune

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës, pajisur me certifikatë per "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate.

Operatori ekonomik ose anëtar i BOE-së që merr përsipër zbatimin e punimeve në terren duhet të disponojë të paktën 1 punonjës të pajisur me certifikatë/trajnim për ‘Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë’, në përputhje me Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010, ‘Për sigurinë dhe shëndetin në punë’, dhe VKM-në nr. 312, datë 05.05.2010, ‘Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier’.

Sipas nenit 88, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të disponojë punonjësin, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. *Shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikate.*

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

***Argumentim:** Kjo kërkesë është në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.*

2.3.13 Mjete dhe paisje

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA	PRONESIA
<i>Ekskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (10-20) ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion me vinc me kapacitet mbajtës të vincit deri në 3.5 Ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autopompe</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobitumatrice</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Freze asfalti</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul vibrues</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
LLOJI I PAISJEVE	SASIA	PRONESIA
<i>Dedektor rrjetesh</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Gjenerator / Motogjenerator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Sonde me kamer për inspektimin e tubave</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibratorë betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Matrapik</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pllakë ngjeshëse me vibrim (min 700 kg)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor me ajër</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Prerese asfalti / betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kalleperi (betoforma)</i>	<i>100 m2</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore).

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat

“a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës).

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, ne përputhje me parashikimet e nenit 4 ,pika38/b dhe nenit 36,te LPP,i ndryshuar,si dhe nenit 40,pika 1 dhe 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimin publik” të ndryshuar.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet për pajisjet IT, kontroll-akses dhe pajisjet ndihmëse janë të domosdoshme për funksionimin e integruar të Portës nr. 4, pasi përfshijnë barrierat automatike, trarët, loop-detektorët, fotocelulat, switch-et industriale, kabllimin, rack-un, UPS-in dhe elementët e komunikimit. Këto pajisje janë kritike për kontrollin fizik të hyrje-daljeve, sigurinë portuale, menaxhimin e trafikut, komunikimin me sistemet ekzistuese dhe vazhdimësinë operacionale.

Specifikimet për zyrën konteinerike janë të nevojshme pasi objekti kërkon një ambient funksional shërbimi dhe teknik, të ndarë në dy ambiente zyre dhe një ambient teknik për pajisjet elektrike/IT, rack, UPS, pajisje komunikimi dhe kontroll-akses. Kërkesat për konstruksionin, ndarjet e brendshme, instalimet, klimatizimin/ventilimin dhe dokumentacionin janë vendosur për të garantuar përdorim të sigurt, funksional dhe të qëndrueshëm.

Specifikimet teknike janë hartuar si kërkesa minimale të detyrueshme dhe lejojnë materiale/pajisje ekuivalente ose me parametra më të lartë teknike, për sa kohë që përmbushen kërkesat minimale funksionale dhe teknike të dokumenteve të tenderit. Për rrjedhojë, ato nuk synojnë kufizimin e konkurrencës, por garantimin e cilësisë, sigurisë, integritetit dhe funksionimit të plotë të objektit.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT